



Primar / Borezuar Priljeva / Prodato Received / Delivery		05 - 05 2021		1		viti god year	
Organ / Rjesta Organ / Jedince Org / Unit	Nr Prot No Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity				
SIKMSHCK	2192/2021		1/4				



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A nr.219/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-** Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.Nr.785/2019 të datës 29.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.61/2019 të datës 01.02.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr. "Asllan Kleqka" P.N, Rahovec, kundër organit të punësimit Komuna e Rahovecit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 05.05.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën A.Nr.61/2019 të datës 01.02.2019 të parashtruar nga ankuesi**

**A r s y e t i m**

Komuna e Rahovecit, bazuar në Autorizimin e datës 21.11.2018 të Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civilë/Ministria e Administratës Publike, ka shpallur me datë 22.11.2018 Konkursin 01Nr.3104 për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Gjeodezi" në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, të Komunës së Rahovecit, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi

Me Vendimin me numër 01Nr.04 të datës 03.01.2019 të Kryetarit të Komunës së Rahovecit, është anuluar procedura e rekrutimit e shpallur me Konkursin 01Nr.3104 të datës 22.11.2018, për shkak të tejkalimit të afateve për zbatimin e veprimeve të procedurës së rekrutimit. Kundër këtij vendimi, ankuesi me datën 09.01.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Rahovecit, ku ky i fundit me Vendimin me numër Nr.71 të datës 25.01.2019 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit me numër Nr.71 të datës 25.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Rahovecit, brenda afatit ligjor respektivisht më datë

01.02.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 556/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.02.2019, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit të Komuna e Rahovecit. Ndërsa Këshilli më datë 15.02.2019 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokoli 833/2019 se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional për shkak të mos emërimit të anëtarëve nga Kuvendi i Kosovës, me s'arsye Këshilli me shkresën numër protokoli 1451/2019 të datës 18.03.2019 ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës së tij me numër A.nr.61/2019 të datës 01.02.2019, duke udhëzuar të njëjtin për të drejtën e ndjekjes së procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Pas këtij njoftimi të Këshillit, ankuesi ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, e cila me Aktgjykimin A.Nr.785/2019 të datës 29.03.2021 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 18.03.2019 dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për ankesën e ankuesit të datës 01.02.2019.

**Kolegji për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosje në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoli 556/2019 të datës 01.02.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.71 të datës 25.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Rahovecit; Ankesën nr.17 të datës 09.01.2019 të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Raportin e listës së shkurtër të datës 13.12.2018; Vendimin 01Nr.04 të datës 03.01.2019 të Kryetarit të Komunës së Rahovecit; Shkresën përcjellëse me numër protokoli 833 të datës 15.02.2019; Përgjigjen në ankesë me numër 01Nr.465 të datës 15.02.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.02.2019; Procesverbalin e datës 18.01.2019 i mbledhjes së Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Raportin e datës 27.12.2018 nga Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Rahovecit; Njoftimin e kandidatëve për testimin nga përzgjedhja e ngushtë i datës 13.12.2018; Ftesën e datës 13.12.2018 përmes e-mailit zyrtar; Vendimin 01Nr.3086 i datës 19.11.2018 për shpalljen e konkursit publik; Autorizimin e datës 21.11.2018; Kërkesën për fillimin e rekrutimit (punësimit) i datës 19.11.2018; Formularin Form.MAP-SHCK-07a; Formularin Form.MAP-SHCK-05; Përshkrimin e detyrave të punës; Vendimin me numër 01.Nr.01/678/18 i datës 12.12.2018 për formimin e Komisionit Përzgjedhës i Shërbimit Civil; Propozim vendimin e datës 12.12.2018; Regjistri i aplikacioneve të pranuar; Listën e shkurtër të datës 13.12.2018; dosja për punësim për Kopja e konkursit dhe Përgjigje në ankesë e datës 15.02.2019 me numër protokoli 833/2019 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/54; E-mail nga C.Z. për Y.R. i datës 19.04.2021; E-mail nga A.TH. për C.Z. i datës 19.04.2021; Aktgjykimi A.nr.785/2019 i datës 29.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që të përfundohet procedimi



administrativ i filluar me ankesën A.Nr.61/2019 të datës 01.02.2019 të parashtruar nga ankuesi  
*sepse,*

Kolegji për shqyrtimin e ankesës bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar së Komuna e Rahovecit, pas aprovimit të shpalljes së Konkursit sipas Autorizimit të Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civilë/Ministria e Administratës Publike të datës 21.11.2018, ka shpallur me datë 22.11.2018 Konkursin 01Nr.3104 për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Gjeodezi" në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Në këtë konkurs kanë aplikuar shtatë (7) kandidatë përfshirë edhe ankuesin. Me Vendimin e Kryetarit të Komunës së Rahovecit 01.Nr.01/675/18 të datës 12.12.2018, është Themeluar Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civilë për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Gjeodezi", i cili me datë 13.12.2018 ka përgatit listën e ngushtë prej 4 kandidateve të cilët sipas vlerësimit të Komisionit kanë plotësuar kushtet për aplikim, dhe të njëjtit janë ftuar për testimin më shkrim me datë 18.12.2018.

Sipas Raportit të datës 27.12.2018 të Udhëheqëses së Personelit të Komunës së Rahovecit, testi me shkrim edhe pse është planifikuar të mbahet më datë 18.12.2018 nuk është mbajtur për shkak së kanë munguar tre (3) anëtarë të Komisionit Përzgjedhës dhe pasi që i njëjti nuk është organizuar brenda afatit ligjor, ka propozuar që të anulohet konkursi i kontestuar me ankesë, e në këtë kuptim, Kolegji konstaton se testimi me shkrim dhe gojë i kandidatëve nuk është zhvilluar brenda afatit prej dhjetë (10) ditësh nga data e listës së ngushtë-shkurtër ashtu siç është përcaktuar me nenin 32 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurën e Rekrutimit të Shërbyesve Civilë ku me të njëjtin thuhet: *Testimi i kandidatëve, të cilët janë përfshirë në listën e shkurtër behët brenda, 10 ditë punë pas marrjes së listës së shkurtër përfundimtare, nga rezulton se tejkalimi i këtij afati ligjor e bën procedurën e rekrutimit në fjalë juridikisht të pa vlefshme.*

Duke vështrim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 104 ku përcaktohet se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë, si dhe duke u nisur nga fakti se procedura e rekrutimit e kontestuar me ankesë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Gjeodezi", është anuluar për shkak të tejkalimit të afateve ligjore për zhvillimin e veprimeve procedurale, Kolegji konstaton se objekti gjegjësisht qëllimi i ankesës së ankuesit është bërë i pamundur, e si rrjedhojë vendosi që të përfundojë procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.Nr.61 të datës 01.02.2019.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A. Nr.219/2021

Çlirim ZEKA

*Çlirim*

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

*Ardita*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit;
- Kryetarit të Komunës së Rahovecit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Rahovecit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

